

# GJENDJA ME GRIPIN NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT, SEZONI 2024/2025 (java e dytë, deri më 12.01.2025)

## Të dhëna javore (mbikëqyrja rutinore/ILI ndaj gripit)


Gjatë javës së dytë të vitit 2025 (nga 06-12.01.2025) në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë raportuar 1.053 ( $I=57,3/100.000$ ) raste të prekure nga gripi/sëmundjet e ngjashme me gripin, për 3,2 herë më shumë se javën e kaluar (331).

Krahasuar me javën e dytë të vitit të kaluar (1.182) numri është zvogëluar për 10,9%, ndërsa sa i përket modelit për 14 sezonet e fundit (614) është regjistruar një rënie prej 16,4%.

Gjatë javës së dytë të vitit 2025 pranë laboratorit të virologjisë të ISHPRMV-së kanë arritur 53 materiale për analiza laboratorike për gripin, paralelisht të analizuar edhe për grip edhe për COVID-19, 26 materiale kanë rezultuar pozitiv për prani të virusit të gripit -14 Influenza A(H3), 9 A(H1)pdm09 dhe 3 Influenza B/Victoria. Janë regjistruar dhe 7 raste pozitive me RSV dhe një pacient me SARS-CoV-2.

Incidenca e aktivitetit sezonal të virusit të gripit ( $I=26,1/100.000$ ) është mbi pragun sezonal, pra është tejkaluar pragu dhe kemi hyrë në sezonin e gripit (Grafiku 1).


**Grafiku 1.** Niveli i intensitetit dhe shpërndarja javore e të sëmurëve me grip/ sëmundje të ngjashme me gripin sipas lakores epidemike të pritur 2010-2024, sezoni 2023/2024 dhe sezoni 2024/2025



Të sëmurët e kësaj jave janë regjistruar në 24 QSHP/NJR : Shkup – 305, Dibër– 134, Kumanovë – 118, Tetovë dhe Gostivar – nga 66, Kavadar – 62, ndërsa në të tjerat numri është  $\leq 50$ .

Sa i përket moshës, tek grupmosha 15-64 janë regjistruar 633 persona, tek grupmosha 5-14 – 179, tek grupmosha mbi 65 vjet – 97 dhe tek fëmijët nga 0-4 -144 raste. Incidencë më e lartë është regjistruar tek grupmosha 5-14 vjet ( $83,3/100.000$ ).

Në 6 njësi raportimi është regjistruar aktivitet shumë i ulët i virusit të gripit, në 14 sezonal, në 3 aktivitet mesatar, dhe në një (Dibër) aktivitet shumë i lartë i gripit (hartogrami 1).



## **МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE – Të dhëna kumulative (mbikëqyrja rutinore/ILI ndaj gripit)**

### **1. МБИКËQYRJA EPIDEMIOLOGJIKE**

Në sezonin 2024/2025 numri i përgjithshëm i rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin është 2.408 (I=131,1/100.000).

Krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonit të kaluar (n=3.500), numri i rasteve të regjistruara ka shënuar një rënie prej 31,2%, ndërsa krahasuar me modelin për 14 vjetët e fundit (n=2.583) është regjistruar një rënie prej 6,8%.

Të sëmurë janë raportuar nga gjithsej 25 QSHP/NJR. Numri më i madh (n=414) është regjistruar në Shkup, ndërsa incidencë më e lartë kumulative (1.991,4/100.000) është regjistruar në territorin e Dibrës.

Sa i përket shpërndarjes së rasteve sipas grupmoshave, numri më i madh i të sëmurëve është regjistruar tek personat e grupmoshës që përfshijnë pjesën më të madhe të popullatës (nga 15-64 vjet) - 1.424 raste (59,1%), ndërsa incidencë më e lartë (266,3/100.000) tek fëmijët e moshës 0-4 vjet (n=257).

Shpërndarja e rasteve me grip/sëmundje të ngjashme me gripin sipas muajve

- tetor – 195 raste ose 8,1%
- nëntor – 259 raste ose 10,7%
- dhjetor – 570 raste ose 23,7%
- janar – 1.384 raste ose 57,5%

Deri më tani nuk janë regjistruar raste të vdekjes si pasojë e gripit.

### **2. МБИКËQYRJA VIROLOGJIKE (rutinore)**

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e dytë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 130 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja rutinore.

Është regjistruar 1 rast me SARS-CoV-2 dhe 5 me RSV, 14 raste me grip - 2 Influenza A(H1)pdm09, 11 Influenza A(H3) dhe 1 Influenza B/Victoria.

## **МБИКËQYRJA SENTINEL NDAJ SARI (Infeksione respiratore akute të rënda)**

Mbikëqyrja sentinel zbatohet si mbikëqyrje shpesh e sistemit të rregullt të mbikëqyrjes së gripit dhe COVID-19 në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e që ka për qëllim fitimin e informacionit më të detajuar për incidencën, intensitetin, llojin e viruseve që qarkullojnë dhe për zbatimin e masave parandaluese në kohë. Mbikëqyrja sentinel SARI kryhet në 6 spitale mbikëqyrëse, 5 në Shkup (KU e Sëmundjeve Infektive dhe Gjendjeve Febrile, KU për Sëmundjet e Fëmijëve, KU e Alergologjisë dhe Pulmologjisë, SPQ 8 Shtatori dhe KU për Sëmundje Respiratore tek Fëmijët - Kozle) në një në Shtip (SK Shtip). Definicioni për rastet SARI sipas të cilit zbatohet mbikëqyrja është në përputhje me definicionin e rastit të dhënë nga OBSH-ja në vitin 2014.

Nga të gjitha vendet sentinel të cilat marrin pjesë, gjatë javës së dytë janë raportuar gjithsej 50 raste me SARI. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=18; 36.0%) janë raportuar nga Klinika për sëmundje të fëmijëve - Shkup. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=17; 34.0%) është regjistruar tek grupmosha 0-4 vjet.

Këtë javë, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 264, ndërsa në kujdes intensiv nuk është shtruar asnjë person. Nga të gjitha pranimet, 18.9% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë prej 23.8% është regjistruar tek personat e grupmoshës nga 30-64 vjet.

Gjatë javës së dytë, për analiza laboratorike kanë arritur 29 materiale nga rastet e raportuara me SARI, të testuara paralelisht për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe/ose RSV. Nga numri i përgjithshëm i materialeve të analizuar (n=29), tek 7 mostra është vërtetuar prani e influenza A(H1)pdm09, tek 6 mostra influenza A(H3) dhe tek 3 mostra influenza B/Victoria. Nuk ka raste me SARS-CoV-2. Nga materialet e dorëzuara, 11 janë testuar për RSV dhe 4 prej tyre kanë rezultuar pozitive.

Kumulativisht, nga vendet sentinel janë regjistruar gjithsej 377 SARI gjatë sezonit 2024/25. Numri më i madh i rasteve me SARI (n=139; 41.2%) është raportuar nga KU e Sëmundjeve Respiratore tek Fëmijët - Kozle. Për sa i përket shpërndarjes sipas moshës, numri më i madh i rasteve me SARI (n=144; 42.7%) janë regjistruar tek grupmosha nga 0-4 vjet.

Kumulativisht, numri i përgjithshëm i pranimeve në vendet sentinel është 3.418, nga të cilët 10 persona janë në repart të kujdesit intensiv. Nga të gjitha pranimet, 9.9% janë si pasojë e SARI. Ngarkesë më e lartë prej 15.1% është regjistruar tek grupmosha nga 30-64 vjet.

Nuk është regjistruar asnjë rast i vdekjes si pasojë e SARI.

Kumulativisht, për analiza laboratorike janë pranuar 175 materiale nga rastet e raportuara SARI. Influenza A(H1)pdm09 është vërtetuar në 8 mostra, influenza A(H3) në 7 dhe Influenza B/Victoria në 3. Janë regjistruar 2 raste pozitive me COVID-19 (SARS-CoV-2).

Nga mostrat SARI, 107 (61.1%) janë testuar edhe për virusin respirator sincicial (RSV), e 15 (14.0%) prej tyre kanë rezultuar pozitive.

### **MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE (mbikëqyrja rutinore + sari) – Të dhëna kumulative përmblendhëse**

Nga fillimi i sezonit 2024/2025, deri në javën e dytë, në laboratorin e virologjisë në ISHPRMV kanë arritur 305 materiale nga institucionet shëndetësore për testim për viruse respiratore nga mbikëqyrja sentinel dhe SARI.

Të gjitha materialet janë testuar edhe për prani të virusit të gripit, SARS-CoV-2 dhe / ose RSV.


Janë detektuar 32 raste pozitive me grip:

- Influenza A – 28 (87,5%)
  - Influenza A(H1)pdm09 – 10 (35,7%)
  - Influenza A(H3) – 18 (64,3%)
  - Influenza A – e pasubtipizuar - 0

- Influenza B – 4 (12,5%)
  - Influenza B/Victoria – 4 (100,0%)
  - Influenza B/Yamagata – 0
  - Influenza B – linjë e papërcaktuar – 0

Janë regjistruar 3 raste pozitive me SARS-CoV-2 dhe 20 raste me RSV.

*Grafiku 2. Shpërndarja javore, numri dhe përqindja e mostrave pozitive të gripit, mbikëqyrja sentinel dhe rutinor, RMV, 2024/2025*



## **KOMENT EPIDEMIOLOGJIK**

Ka një rritje të numrit të sëmundjeve të ngjashme me gripin, i cili për herë të parë për këtë sezon është mbi kufirin javor për aktivitetin sezonal. Rezultatet e mbikëqyrjes virologjike të gripit tregojnë se ka një aktivitet rajonal të virusit të influencës. Sipas këtyre të dhënave, Maqedonia e Veriut ka intensitet mesatar të virusit të gripit.

## **VAKSINIMI KUNDËR GRIPIT SEZONAL**

Vaksinimi kundër gripit është mbrojtja më e mirë nga kjo sëmundje, prandaj Instituti i shëndetit publik e rekomandon atë për të gjithë popullatën, sidomos për personat që përkasin në grupet vullnerable (sipas rekomandimeve të OBSH-së):

- Personat e moshuar (mbi 65 vjet)
- Fëmijët në moshë nga 6 deri në 59 muaj
- Personat mbi 6 muaj e me sëmundje kronike
- Gratë shtatzëna dhe
- Punonjësit shëndetësorë.

Për sezonin 2024/2025, Ministria e shëndetësisë siguroi 70 000 doza të vaksinë katërvalente falas për këto kategori të popullatës. 10.000 doza doza shtesë të vaksinës katër valente janë siguruar përmes donacionit nga PIVI (Partnership for Influenza Vaccine Introduction).

Vaksinimi kundër gripit për sezonin 2024/2025 filloi në 21.10.2024 dhe zbatohet në Shtëpitë e shëndetit dhe/ose Qendrat e shëndetit publik me Njësitë e tyre rajonale. Caktimi i termineve për vaksinat falas bëhet nëpërmjet uebfaqes [www.vaksinacija.mk](http://www.vaksinacija.mk).

Sipas Drejtorisë për Shëndetësi Elektronike nga fillimi i vaksinimit e deri në mbylljen e këtij raporti gjithsej janë vaksinuar 70.415 persona që bëjnë pjesë në kategoritë e grupeve të cenueshme të popullatës.

2.600 vakcina komerciale shtesë janë siguruar nga ana e Qendrave të shëndetit publik si vakcina për pjesën tjetër të popullatës dhe ato mund të merren për një kompensim financiar të caktuar në Qendrat e shëndetit publik dhe Njësitë e tyre rajonale.

Sa i përket vaksinave komerciale, deri më tani janë vaksinuar 1.903 persona.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë vaksinuar gjithsej 72.318 persona me vakcina falas dhe komerciale.

## **RAJONI EVROPIAN - ERVISS (European Respiratory Virus Surveillance Summary)**

\*Burimi: <https://erviss.org/>

Raporti për gjendjen me gripin në Rajonin Evropian për javën e parë të vitit 2025 tregon se aktiviteti i virusit të gripit në Rajonin Evropian të OBSH-së:

- Shkalla e morbiditetit të gripit (ILI) dhe /ose infeksioneve respiratore akute është rritur mbi nivelet bazë në 16 nga 30 vende të rajonit evropian të OBSH-së.
- Edhe pse ka variacione në vende të ndryshme, numri i rasteve pozitive mbetet i lartë. Është rritur edhe përqindja e rasteve pozitive me grip nga SARI. Të moshuarit përbëjnë numrin më të madh të të prekurve. Rritje ka shënuar edhe numri i hospitalizimeve si pasojë e gripit. Influenza A(H1)pdm09 është nënlloji dominant në rajon.
- Pozitiviteti i RSV mbetet mesatar në nivel rajonal.
- Aktiviteti i SARS-CoV-2 mbetet i ulët në të gjithë rajonin, me variacione të caktuara në disa vende.
- Detektimet e vërtetuara të infektiveve me virusin e gripit nga ISHP sentinel gjatë javës së kaluar ishin Influenza A (84%) - A(H1)pdm09 (86%) dhe A(H3) (14%).
- Në rajon,nga mostrat e pacientëve të mbikëqyrjes ndaj SARI:
  - Përqindja e detektimit të virusit të gripit është 20% krahasuar me 16% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 23% (shtrirja: 0–48%).
    - Detektimet e vërtetuara të infeksioneve me virusin e gripit nga SARI sentinel për javën e kaluar ishin Influenza A (87%) - A(H1)pdm09 (85%) dhe A(H3) (15%).
  - Pozitiviteti i SARS-CoV-2 ishte 3% krahasuar me 5% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 1% (shtrirja: 0–8%).
  - Pozitiviteti i RSV e 13% krahasuar me 13% që ishte gjatë javës së kaluar. Aktiviteti mesatar ishte 7% (shtrirja: 1-33%).

Nga 32 vende të cilat raportojnë për intensitetin e gripit: 14 kanë raportuar për intensitet mesatar dhe të lartë.

Nga 32 vende të cilat raportojnë për shpërndarjen gjeografike të gripit: 24 kanë raportuar për shpërndarje të gjerë të virusit të gripit.

**Departamenti i epidemiologjisë të sëmundjeve ngjitëse  
Instituti i Shëndetit Publik**